



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:146148

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733156

Ac.nr.2942/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi - Saraçi, në çështjen kontestimore të paditësit R. B nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson I. M avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Republika e Kosovës – Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Ambientit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës Prishtinë të përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.64/19 të datës 19.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Republika e Kosovës – Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Ambientit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.64/19 i datës 19.03.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit miratohet, në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. B nga Ferizaj dhe detyrohet e paditura Republika e Kosovës – Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Ambientit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës Prishtinë, që paditësit të i'a paguaj shumën prej 7,690.00€ në emër të dëmit material të pësuar në automjetin e markës ..., me ngjyrë të ..., viti i prodhimit ... Në pikën II., të dispozitivit detyrohet e paditura që paditësit të i'a paguaj shumën nga pika -I- e këtij

dispozitivi të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 689€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Në pikën III., të dispozitivit të gjitha këto me kamatë prej 8% duke filluar nga data 23.02.2021 (data e seancës kryesore e deri në pagesën definitive).

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës, të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi R. B ka parashtruar padi ndaj të paditurës Republika e Kosovës – Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Ambientit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit të i'a paguaj shumën prej 7,690.00€ në emër të demit material të pësuar në automjetin e markës ..., me ngjyrë të ..., viti i prodhimit ...

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: raporti i aksidentit datë 22.01.2019, raporti i policit hetues me numër të rastit 2019-CFT-47, proforma mbi vlerën e pjesëve të automjetit të dëmtuar në 8 fletë, kopja e librezës së automjetit, kopja e polices së sigurimit me numër 0006841918, kopja e dokumenteve të identifikimit për paditësin, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit, fotot e automjetit të dëmtuar si dhe ekspertiza e makinerisë nga eksperti S. B e datës 12.03.2020, pa pyetje dhe pa vërejtje.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datë 22.01.2019 rreth orës 16:00 min. në vendin e quajtur "... " (...) në magjistralen ...- ..., në Komunën e Kaçanikut. Deri te aksidenti ka ardhur kur vozitësi i automjetit ... me ngjyrë të ..., me tabela ..., R. B, ishte duke drejtuar automjetin e tij nga ...-... dhe me të arritur në vendin e quajtur ... në ..., papritmas nga ana e majtë e lëvizjes së tij, bie një dru nga mali në pjesën e përparme të

automjetit, me ç' rast në veturën e paditësit janë shkaktuar dëme materiale si pasojë e dëmtimeve në pjesën e përparme të automjetit.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur".

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nga gjendja e vërtetuar faktike kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykim i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtyllë, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestimore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesës së parashtruar me propozim dhe në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Lidhur me pretendimet ankimore për mosekzistimin e bazës për kompensim nga ana e të paditurës, kolegji gjen se, në shkresat e lëndës gjendet raporti i aksidentit dhe raporti i policit hetues, që e dokumentojnë një gjë të tillë. Nga shkresat e lëndës kolegji gjen se në aksidentin e datës 22.01.2019 paditësit i është dëmtuar vetura e tipit ..., ku R. B ishte duke e drejtuar automjetin e tij nga ...-... dhe me të arritur në vendin e quajtur “...” në ..., papritmas nga ana e majtë e lëvizjes së tij, bie një dru nga mali në pjesën e përparme të automjetit, me ç’rast në veturën e paditësit janë shkaktuar dëme materiale si pasojë e dëmtimeve në pjesën e përparme të automjetit. Pretendimet e të paditurave se këtë pjesë të rrugës ka qenë duke e mirëmbajtur nja Kompani tjetër, kolegji i Gjykatës së Apelit i ka refuzuar si të pa bazuara. Kolegji gjen se ... është nën menaxhimin direkt të të paditurave. Dëmi është shkaktuar nga druri që ka rënë mbi rrugën automobilistike gjatë lëvizjes së automjetit gjë që krijon përgjegjësinë e të paditurave për mbikëqyrjen e ... Kolegji i Gjykatës së Apelit ka miratuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë që dëmi është shkaktuar nën përgjegjësinë deliktore civile të të paditurave dhe çdo dëmtim që mund tu shkaktohet personave të tretë si pasojë e jo ndonjë mbikëqyrje të duhur, krijon përgjegjësinë e vetë të paditurave për shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Kolegji ka miratuar edhe vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me lartësinë e dëmit të shkaktuar. Nga ekspertiza e ekspertit e makinerisë e datës 12.03.2020 është vërtetuar se automjeti mund të riparohet dhe puna e tërësishme së bashku me pjesët për ndërrim arrijnë shumën 7,690.00€. Lidhur me ekspertimin e kryer nga eksperti në fjalë, kolegji ekspertizën e kryer lidhur me këtë çështje e ka vlerësuar si të rregullt dhe profesionale, ngase përmban të gjithë parametrat vlerësues dhe përmbushin konditat e një ekspertimi të rregullt në një çështje të tillë të vlerësimit.

Kolegji gjen se, në nenin 322.3 të LPK-së është përcaktuar se: *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret e paditura përveç kontestimit verbal, nuk ka ofruar ndonjë provë që do të provonte një gjendje tjetër nga sa është vendosur. Bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, *secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*. Për këto arsye kolegji i gjykatës së shkallës së dytë ka vlerësuar se pala e paditur nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e parashtruar për këtë çështje, është vlerësuar si e pa themeltë dhe për këtë gjë edhe është refuzuar si e pa bazuar, kurse është vërtetuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2942/2021 me datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj